

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Maliq, më 25.04.2024

PROJEKT -VENDIM - 14 R. 7

“Për një ndryshim në buxhetin e vitit 2024”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak” gërma (dh), ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 32 , “Përgatitja dhe miratimi buxheteve vendore”, ligjit nr.68/2018 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 45 “Rishpërndarja e fondeve buxhetore” , ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 138 dt. 26.12.2023 ”Për miratimin e buxhetit për vitin 2024”, Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Vendim të Këshillit të Ministrave nr.9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet ti nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste” i kërkoj Këshillit të Bashkisë

1. Të miratojë ndryshim në buxhetin e viti 2024 si më poshtë vijon


<u>Pakësim</u>					<i>në 000/lekë</i>
Gr.	Kap.	Kod. Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti	
00	05	0 1110	230	1680324	<u>3,900</u>
<u>Shtesë</u>					
Gr.	Kap.	Kod, Prog.	Llog.Ek.	Kodi Objekti	
00	05	01110	230		2,000
00	05	04520	602	9999999	1,100
00	05	04260	602	9999999	800

- Fondi i lartpërmendur të pakësohet nga zëri bashkëfinancim projektesh i parashikuar në buxhetin e vitit 2024 dhe të përdoret për:
 - Pagesë të oponencave teknike të projekteve në ndërtim.
 - Transport çakëll për riparim rrugë të fshatrave e parcelave
 - Broshura Prezantuese “Pylli i Fazënëve” në rajonin tonë në kuadër të projekteve Intereg Balkan -Mediterranean .
- Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashki.

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Maliq, më 25.04.2024

RELACION

Mbi ndryshimin e buxhetit për vitin 2024 për efekt të kryerjes së “Oponencës Teknike të Projekteve dhe çakëllim rrugë të fshatrave e parcelave”

a-Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.9, datë 11.1.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste” është përcaktuar detyrimi edhe i organeve të qeverisjes vendore për të kryer oponencë teknike për projektet e ndërtimit .

Në këtë aspekt po ju paraqesim këtë projekt-vendim për ndryshime në buxhetin e vitit 2024, për efekt të pagesave për institucionet që janë të ngarkuara nga ky vendim për kryerjen e oponencës teknike të projekteve në ndërtim .

Nga ana jonë është bërë një përllogaritje paraprake për këtë qëllim për objektet e parashikuar në buxhetin e vitit 2024 bazuar edhe në tarifatat për oponencën teknike për projektet e veprave të ndërtimit sipas VKM nr.9, datë 11.1.2024 “Për miratimin e rregullave për projektet që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”.

Tarifatat variojnë nga 4 – 7 % në varësi të kostos së llogaritshme në (milion lekë) të vlerës së projektit dhe projektimit.

b-Riparimi i rrugëve të fshatrave apo parcelave është një tjetër piksynim i punës sonë. Për të kursyer fonde , çakëlli do të merret në territorin e bashkisë, do të ngrakohet nga mjetet tona dhe ne do të paguajmë vetëm transportin.

c- Broshurë Prezantuese “Pylli i Fazënëve” Në kuadër të projekteve me Bashkimin Europian për rajonin tonë “Interreg Balkan –Mediterranean” do të prodhojmë një prezantim , një dokument ,broshurë, flet-palosje(tip guide) në disa gjuhë për t’ju shpërndarë turistëve apo qytetarëve të rajonit tonë .

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU